

Raporti i Konferencës:
Profilat Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Prizrenit
Prizren, 21 Janar 2020

Ky botim është pjesë e programit të Konzortiumit të OJQ-ve (ATRC, KIPRED, BIRN, SPRC, KCBS dhe D+) “Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm”.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm"



Përgatitur nga: Lulzim Peci, Mentor Agani, Diedon Nixha dhe Valdrin Ukshini.

Copyright © 2020, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 542 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

Rr. Major Mehmet Bushi, H.III. No.1

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 542 778

Hyrje

Më 21 janar 2020 në Prizren u mbajt Konferenca Rajonale në temën “Profili Socio-Ekonomik i Komunave të Rajonit të Prizrenit,” e organizuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, të udhëheqësive dhe asambleve komunale të komunave të këtij rajoni. Në këtë konferencë u prezantuan dhe diskutuan gjetjet e punimit të KIPRED-it “Profilet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Prizrenit,”¹ diskutim ky që kishte për qëllim të përdoret si nxitje për hapjen e debatit publik, si dhe të ndihmojë vendim-marrësit komunalë dhe kombëtarë për formulimin dhe zbatimin e politikave që do t’i adresojnë nevojat e popullatës së re, më në veçanti të grup-moshës 15–29 vjet. Nga gjetjet e punimit dhe diskutimet e Konferencës janë identifikuar çështjet në vijim që kërkojnë trajtim urgjent nga autoritetet komunale dhe kombëtare:

- A. Si në nivelin komunal, ashtu edhe në atë qendror, duhet të punohet për një reformim të sistemit arsimor ashtu që të arrihet një përputhje midis kërkesave të bizneseve për punësim, dhe ofertës së profileve të arsimit të mesëm dhe të lartë. Gjatë kësaj, autoritetet qendrore dhe ato lokale duhet të koordinohen për ta zgjidhur problemin e mësimdhënësve të profileve që do të zhduken gjatë kësaj reforme.
- B. Komunat duhet ta zhvillojnë dhe avancojnë praktikën ku çështjet e rinisë do të jenë çështje jo vetëm të Drejtorive Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, por edhe të drejtorive të tjera. Gjatë trajtimit të problemeve të tyre, ato drejtori të tjera

¹ *Profilet Socio-Ekonomike të Komunave të Rajonit të Prizrenit*, KIPRED, shkurt 2020.

duhen gjithmonë të përpiqen që ato probleme t'i zgjidhin, mes tjerash, edhe nga këndvështrimi i nevojave të rinisë.

- C. Autoritetet qendrore duhet të përpilojnë dhe miratojnë ligje të efektshme për mbrojtjen e punëtorëve në sektorin privat, të ngjashme me ato që ekzistojnë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve shtetërorë, duke i patur gjithmonë parasysh veçantitë e sektorit privat.
- D. Raportet e punës së Këshillit për Siguri në Bashkësi të Komunës së Prizrenit duhet të jenë të plota dhe transparente.
- E. Duhet të bëhet hapja e Këshillit Rinor Lokal dhe e Qendrës Rinore të Prizrenit, të cilat do të jenë funksionale, dhe duhet të bëhet përkrahja buxhetore e punës së tyre nga ana e Komunës së Prizrenit.
- F. Autoritetet komunale, në bashkëpunim me ato qendrore, duhet të përpilojnë dhe t'i bëjnë funksionale mekanizmat efikas për analizën dhe vlerësimin e projekteve të tyre të mëparshme, dhe atë, si të projekteve të tyre vetjake, ashtu edhe të atyre që janë implementuar në bashkëpunim me organizata të tjera të ndryshme.
- G. Në kuadër të avancimit të gjendjes së rinisë, komunat duhet ta zhvillojnë së më shumë që të jetë e mundur praktikën e bashkëpunimit të tyre me organizatat e shoqërisë civile, dhe për arritjen e këtij qëllimi ato duhet t'i bëjnë edhe ndarjet përkatëse buxhetore.
- H. Në rajonet ku më shumë komuna janë të përqendruara në veprimtari të ngjashme apo të njëjta (si, për shembull, në veprimtarinë e turizmit, ku janë të përqendruara disa nga komunat e rajonit të Prizrenit), komunat e përqendruara në ato veprimtari duhet ta zhvillojnë dhe avancojnë sa më shumë që të jetë e

mundur praktikën e bashkëpunimit dhe të bashkëveprimit ndërkomunal në këto veprimtari.

- I. Duhet të bëhet një organizim dhe koordinim i autoriteteve qendrore dhe të atyre lokale me qëllim të përballjes me problemin e përdorimit të drogave nga ana e rinisë.
- J. Regjistrimi i popullatës në nivelin qendror e përfshin vetëm regjistrimin e banorëve rezident në Kosovë, ndërkaq, në disa nga komunat që kanë numër më të madh të banorëve në mërgatë, në disa raste, si popullatë komunale merren edhe banorët e tyre që jetojnë jashtë Kosovës. Meqenëse kjo shkakton numra të ndryshëm për popullatat komunale në nivelin qendror dhe në atë komunal, dhe, nga ana tjetër, ndarjet buxhetore për buxhetet komunale bëhen duke u bazuar në numrin e banorëve të komunave, autoritetet qendrore dhe ato komunale duhen që bashkarisht ta adresojnë dhe ta zgjidhin problemin e kësaj mospërputhjeje në numrin e banorëve të komunave.

Për të patur një ndërlidhje sa më të mirë midis punimit të prezantuar dhe diskutimeve në konferencë, ato do t'i përmbledhim sipas komunave përkatëse të rajonit të Prizrenit.

Komuna e Prizrenit

Pas pjesës hyrëse të Konferencës, ku organizatori e bëri prezantimin e Profilit Socio-Ekonomik të Komunave të Rajonit të Prizrenit, fjalën e mori Kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Mytahir Haskuka. Në fillim ai e lavdëroi Profilin e prezantuar, duke theksuar që ky profil kryesisht deskriptiv, do të jetë shumë i dobishëm me të dhënat e veta.

Pas kësaj ai u përqendrua në faktorët që sipas tij e rrisin rrezikun e radikalizimit fetar të të rinjve, në komunat e Rajonit të Prizrenit, dhe më gjerë. Këta faktorë, sipas tij, janë tre: 1) Gjendja e arsimimit të të rinjve; 2) Përfshirja e rinisë në aktivitetet jashtë-mësimore – kulturë, sport, etj., dhe; 3) Përgatitja profesionale e rinisë për jetën e tyre, pra, aftësimi profesional për punë. Kryetari Haskuka e potencoi që kur rinia ka perspektivë të mirë në këto tri fusha, atëherë rreziku, jo vetëm nga radikalizimi dhe terrorizmi, por edhe nga dukuritë e devijimet e tjera (kriminaliteti, drogat, etj.), do të jetë shumë më i ulët.

Kryetari Haskuka e dha një vërejtje për mënyrën si është analizuar buxheti dhe shpenzimet buxhetore për rini në Profil. Ai potencoi që, lidhur me tre faktorët e sipërpërmendur që ndikojnë në rrezikun për radikalizim, këtu është dashur të merren parasysh edhe investimet që komunat i bëjnë për rininë edhe përmes drejtorive të tjera, dhe jo vetëm investimet që janë përmendur në Profil. Lidhur me këtë ai si ilustrim i përmendi investimet që Komuna e Prizrenit i ka bërë për rininë përmes Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Për shembull, tha ai, kjo Drejtori e ka patur një projekt të përbashkët me Organizatën Help, ku janë ndihmuar 42 ndërmarrës të rinj për bizneset e tyre, dhe ku janë ofruar mjete të punës, kompjuterë, makina të punës, trajnime në kontabilizëm, dhe të gjitha këto me mbështetjen, si të Komunës së Prizrenit,

ashtu edhe të Help-it. Në total, shtoi ai, këtu janë punësuar rreth 80 persona, dhe kjo ndërmarrje, edhe pse është bërë në kuadër të përpjekjeve për zhvillim ekonomik, në thelb ka qenë investim në rini.

Po ashtu, z. Haskuka i përmendi edhe investimet e bëra në fushën e turizmit. Qëllim këtu ka qenë zhvillimi i produkteve të reja turistike, gjë kjo që e ndihmon eliminimin e rrezikut të radikalizimit dhe të dukurive të tjera negative. Në këto produkte, tha ai, idetë e reja, organizimet, inovacioni, vijnë nga grup-mosha 18–29 vjet. Kështu, vitin e kaluar janë lansuar projektet e paragllajdingut, të lëshimit me kajak, të lëshimit me biçikletë, dhe të formave të ndryshme të bjeshkatarisë. Numri i të rinjve që merren me këto sporte, sipas Kryetarit Haskuka, kohëve të fundit është dyfishuar, dhe vazhdon të rritet. Kjo, edhe është rekreative, edhe siguron të ardhura. Në Prizren, përfundoi ai, janë rreth 10 organizata që merren me turizëm të tillë individual, bjeshkatarë e sporte të tjera të ngjashme.

Pas kësaj, Kryetari Haskuka i përmendi po ashtu edhe investimet e ministrive të ndryshme në sport, rekreacion e kulturë, si, për shembull, investimet në pishinë, në terrenet e ndryshme sportive, investimet në shtëpitë e kulturës, dhe në hapësirat e tjera që shfrytëzohen nga rinia.

Një çështje problematike, vazhdoi ai, jo vetëm për komunën e Prizrenit, por edhe për nivelin qendror, është shpërputhja e theksuar midis fushës së arsimit dhe asaj të ekonomisë, më konkretisht, midis kërkesave të bizneseve për punësim, nga njëra anë, dhe ofertës së profileve të arsimit të mesëm dhe atij universitar. Ai përmendi që në takimet e shpeshta që Komuna e Prizrenit i ka me bizneset, ato vazhdimisht ankohen që nuk mund të gjejnë teknologë, inxhinierë të fushave të veçanta, saldues, punëtorë tekstili, etj. – ndërkaq, arsimi është i orientuar kryesisht në shkencat shoqërore, në prodhimin e ekonomistëve, të juristëve, e të ngjashme. Në këtë mënyrë, Kryetari

Haskuka thekson që ka konkurse që i shpall Komuna, ku për një vend pune të juristit paraqiten nga 300 e më shumë kandidatë, ndërkohë që bizneset kanë telashe të mëdha për të gjetur punëtorë të veçantë për një profil të caktuar. Kjo është, pra, një pjesë tejet problematike e ndërlidhur me punësimin, dhe që kërkon reformë të sistemit të arsimit.

Për t'i ilustruar këto, Kryetari Haskuka e përmendi Panairin e fundit të Punës në Prizren, ku bizneset i kanë ofruar që në fillim rreth 600 vende të punës, por numri i aplikimeve ka qenë shumë më i ulët. Si një ilustrim tjetër, Kryetari Haskuka e theksoi që ky aspekt i problemit vërehet edhe në fushën e hotelierisë. Në kohën e fundit, sipas tij, në Prizren është hapur një numër mjaft i madh i hoteleve, dhe edhe këto kanë probleme me gjetjen dhe punësimin e stafit të shkolluar dhe të diplomuar për vendet e tyre të punës.

Në fund të fjalës së tij, duke folur për shpërputhjen midis kërkesës së tregut të punës dhe ofertës së arsimit, Kryetari Haskuka theksoi që duhet të bëhet një analizë më e thellë dhe e mirëfilltë e kësaj problematike, si dhe që Komuna e Prizrenit, në kuadër të Drejtorisë së vet të Arsimit këtë analizë e bën në një formë më bazike, për ata që e përfundojnë shkollën fillore dhe të mesme. Qëllimi i një analize të tillë do të duhej të ishte fuqizimi i shkollave profesionale, i qendrave të kompetencës, i shkollave teknike, i aspekteve praktike të shkollave ekonomike, ashtu që kjo shpërputhje midis kërkesës dhe ofertës në tregun e punës të zvogëlohet sa më shumë.

Lidhur me problemet që i diskutoi Kryetari Haskuka, organizatorët e Konferencës nga KIPRED-i theksuan që e njëjta problematikë është theksuar edhe në konferencat e mbajtura në rajonet e tjera, gjatë prezantimit të Profileve të mëparshme. Kjo u ilustrua me rastin e Komunës së Kamenicës, ku ishte theksuar problemi që në fushën e bujqësisë, bujqit e Kamenicës, për shkak të mungesës së punëtorëve, fuqinë punëtore e grumbullojnë nga punëtorët që në Kosovë vijnë nga Kukësi dhe Tropoja.

Lidhur me këto mendime të shprehura nga Kryetari Haskuka, komentoi Kryetari i Komunës së Dragashit, z. Shaban Shabani, i cili në fillim e shprehi pajtimin parimor me nevojën e përmendur për krijimin e profileve të reja për të cilat ekziston kërkesa në treg. Mirëpo, ai e theksoi problemin me të cilin do të përballen komunat kur të mbyllen drejtimet e vjetra, dhe kur personeli i atyre drejtimeve të vjetra të mbetet pa punë. Ministria, siç e theksoi ai, kërkon nga komunat që të kujdeset për atë staf, kështu që ata në fund do të mbeten barrë e komunës. Prandaj, tha z. Shabani, te reformimi i sistemit arsimor duhet të shkohet me shumë kujdes sa i përket problemeve të implementimit dhe të sistemimit të personelit që do të mbetet pa punë. Ideja, shtoi Kryetari Shabani, është shumë e mirë, mirëpo implementimi i saj, sipas tij, mund të hasë në vështirësi të mëdha për komunat.

Pas kësaj, Laureta Tafaj, asambleiste e Kuvendit Komunal të Suharekës nga radhët e Vetëvendosjes, Kryetarit Haskuka ia shtroi pyetjen lidhur me atë se sa u ka ndihmuar Komuna e Prizrenit të rinjve pa e llogaritur këtu ndihmën e organizatës Help. Po ashtu, ajo u interesua për atë se çfarë ka bërë Komuna e Prizrenit gjatë mandatit të tij për terrenet sportive në Prizren.

Lidhur me ndihmën e Help-it, Kryetari Haskuka u përgjegj se në vitin 2018 kanë qenë 40 përfitues, dhe atë pa ndihmën e Help-it, ndërkaq, Help-i është përfshirë në këtë veprimtari në vitin 2019, për ta rritur bashkëpunimin, ndihmën, dhe mbikëqyrjen. Ai theksoi që në Drejtorinë e Turizmit dhe të Zhvillimit Ekonomik shumica e projekteve janë bërë pa ndihmën e Help-it, por që ka patur bashkëpunim edhe me organizata të tjera.

Si ilustrim, Kryetari Haskuka përmendi subvencionet në bujqësi, dhe donacionin e lopëve qumështore për fermerët. Në vitin 2016 është bërë donacioni i 40 lopëve, ndërkaq, deri në vitin 2019 ky numër është rritur në 99 lopë, në një situatë kur kanë

qenë më shumë se 350 aplikues. Qëllimi i këtij projekti ka qenë vetëpunësimi. Tash, tha ai, është duke u gjetur dhe analizuar profili i përfituesve, por për këtë, sipas tij, nevojitet një kohë më e gjatë, për të patur mundësi për t'i parë trendet afatgjata: analiza e përfituesve, mosha, gjinia, efektet e projektit, punësimi, rritja e prodhimit të qumështit, etj.

Ndërkaq, lidhur me pyetjen për terrenet sportive në Prizren, Kryetari Haskuka theksoi që në vitin 2018, pa asnjë buxhet, është bërë ndërtimi i pesë terreneve në shkollat e Prizrenit. Te qendrat sportive është bërë rregullimi i tribunave, por edhe i vetë terreneve për hendboll, basketboll, tenis, ku te shkolla '11 Marsi' kanë qenë dy terrene tenisi, dhe terreni futboll/basketboll/volejboll. Po ashtu, është ndihmuar edhe ndërtimi i palestrave për fitnes. Kryetari Haskuka e përmendi edhe ndihmën e Ministrisë së Kulturës për ndërtimin e stadiumit në Sërbicë, në Lubizhdë, dhe shtoi që edhe këtu Komuna e Prizrenit e bën pjesën e stadiumit për atletikë, sipas standardeve ndërkombëtare. Në fund ai përmendi edhe fillimin e ndërtimit të stadiumit në Zhur, sipas standardeve të UEFA-s, si dhe shprehu besimin që gjatë këtij viti do të finalizohet edhe puna në stadiumin 'Përparim Thaqi,' edhe përkundrejt disa problemeve që kanë dalë me operatorin.

Pas kësaj fjalën e mori Xhavit Shala, asambleist në Kuvendin e Prizrenit nga radhët e AAK-së. Në fjalën e tij ai për eliminimin e problemeve të përmendura e propozoi ndërtimin e një numri më të madh të mini-stacioneve policore nëpër lagje, ashtu siç është kërkuar në Has, në lagjet 11 Marsi dhe 2 Korriku, ashtu që Policia në shërbimin e qytetarëve të jetë sa më afër tyre.

Duke folur për problematikën e punësimit të të rinjëve, asambleisti Shala mes tjerash u përqendrua në atë që e tha Kryetari Haskuka, që në një konkurs aplikojnë më shumë se 300 aplikantë, ndërkohë që sektori privat mundohet të gjejë punëtorë. Për ta zgjidhur

këtë problem, tha z. Shala, duhen miratuar ligje që i mbrojnë punëtorët në sektorin privat. Ligji për punëtorët shtetërorë, theksoi Shala, ekziston, ai nuk është ligji më i mirë, mirëpo ekziston. Dhe ligje të tilla duhet të ketë edhe për sektorin privat, shtoi ai.

Asambleisti Shala po ashtu bëri vërejtje për punën e Këshillit për Siguri në Bashkësi. Në Komunën e Prizrenit Këshilli për Siguri në Bashkësi ekziston, tha ai, mirëpo, në raportet për atë se çfarë bisedohet dhe çfarë vendimesh merren në të dalin fare pak të dhëna. Për punën e suksesshme të këtij Këshilli, është i domosdoshëm një informim më i gjerë i opinionit.

Në fillim të fjalës së tij, Visar Haxhifazliu, përfaqësues i Organizatës Rinore THY të Prizrenit theksoi që Organizata e tij tashmë ka kërkuar që të ndryshohet ligji për të rinjtë që ata i klasifikon si mosha nga 15 deri në 24 vjet, dhe që ky brez i moshës së të rinjve të merret nga 15 deri në 29 vjet. Ai e shprehu kënaqësinë që Profili i Komunave të Rajonit të Prizrenit i KIPRED-it të rinjtë i merr si grup-mosha 15–29 vjet, ashtu siç ka propozuar organizata e tij.

Ai e diskutoi kërkesën e organizatës së tij THY që të krijohet një kod i veçantë buxhetor vetëm për rini, pa e përfshirë në të edhe kulturën e sportin, meqë shumica e fondeve të përbashkëta shkojnë për kulturë e sport, dhe më pak për rininë si të tillë. Rinia, sipas tij, nuk merret vetëm me kulturë e sport, dhe në Komunën e Prizrenit buxheti i ndarë për të trijat për numrin e të rinjve nuk është as 50 cent për një të ri.

Ai po ashtu e parashtrroi kërkesën për hapjen e Këshillit për Veprim Rinor Lokal, si dhe të një Qendre Rinore në Prizren, ashtu që këto të jenë funksionale, meqë Qendra aktuale Rinore në Prizren nuk ka qenë funksionale për 5 deri në 7 vite.

Në fund, fjalën e mori përsëri Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, që i përmendi edhe disa çështje të tjera, si dhe komentoi dhe u përgjigj në disa çështje dhe

pyetje që u shtruan gjatë Konferencës. Në fillim ai u përqendrua në problemin sipas tij kryesor të pjesëmarrjes së gruas në tregun e punës. Ky, sipas tij qëndron në mungesën e çerdheve me çmim të përballueshëm për gratë që punojnë. Kur ato e paguajnë çmimin e çerdhës për, të themi, dy fëmijë, atyre nga paga e fituar u mbetet fare pak, dhe ky është një faktor tejet demotivues që gratë ta marrin vendimin për t'u punësuar. Ky është faktori ndër kryesorët që bën që ato të qëndrojnë në shtëpi.

Më pas, Kryetari Haskuka shprehu mospajtim me Visar Haxhifazliun e Organizatës Rinore THY, lidhur me idenë e shprehur që rinia të trajtohet si e veçuar, dhe jo së bashku me kulturën dhe sportin. Ai, përkundrazi, mendon që kulturës dhe sportit duhet t'i shtohet edhe arsimit. Ai e përmendi si ilustrim rastin e organizimit të shfaqjeve teatrore për fëmijë të organizuar nga Komuna: këtu, me një çmim fare të ulët, tha ai, gjithsej 50 cent për fëmijë, është organizuar shfaqja teatrore e Pinokut, të cilën e kanë përcjellur edhe prindërit e tyre, por me pagesa të vetat. Këtë shfaqje e kanë përcjellur mbi 6.000 fëmijë, kjo ka qenë shfaqja më e shikuar në Komunën e Prizrenit, dhe rreth 80–90% të këtyre fëmijëve janë deklaruar që kurrë më parë nuk kishin qenë në teatër. Ky organizim, shtoi Kryetari Haskuka, ndoshta është diçka fare e vogël, por e ka arritur shoqërimin e fëmijëve, kënaqjen e tyre, dhe edhe përfitime për Teatrin. Pra, shtoi Kryetari Haskuka, gjërat duhen shikuar nga aspekti i përgjithshëm, jo i veçantë.

Lidhur me disa vërejtje që në diskutime u bënë për mënyrën e dhënies së subvencioneve, Kryetari Haskuka ritheksoi nevojën për analizimin e projekteve të implementuara. Pra, theksoi ai, duhet të bëhet një implementim sa më i mirë, si dhe një analizë dhe vlerësim i çdonjërit dhe i të gjitha projekteve të implementuara, gjë të cilën, siç e tha, edhe ai, dhe edhe Komuna, e kanë nxitur gjithmonë.

Më pas, duke iu kthyer çështjes së arsimit, Kryetari Haskuka shtoi që një problem i madh që e shkakton gjendja e tashme në arsim është që të rinjtë, të shtyrë nga situata e

rëndë, ikin nga arsimi dhe orientohen në gjetje të punës si dhe drejt biznesit. Zgjidhjet që i ka provuar Komuna e Prizrenit për këtë problem kanë qenë: 1) dhënia e bursave, ku numri i tyre fillestar ka qenë 40, dhe vitin e kaluar është rritur në 80, dhe këto janë dhënë në fushat për të cilat ka kërkesë më të madhe në treg – është rritur numri i bursave në inxhinieri dhe në mjekësi, dhe është zvogëluar numri i tyre në ekonomi dhe në drejtësi; Kryetari Haskuka po ashtu theksoi që është rritur edhe numri i bursave për studentët që studiojnë jashtë vendit. 2) Së bashku me Zyren për Punësim të Universitetit të Prizrenit janë zhvilluar projekte për praktikën në punë gjatë studimeve. 3) Së bashku me organizatat e shoqërisë civile janë duke u organizuar projekte të trajnimit profesional, ku si ilustrim u përmendën kurset e organizuara për filigrani, një zeje kjo që është duke u zhdukur. Këtu tridhjetë veta i kanë përcjellur kurset, dhe pesë prej tyre kanë vazhduar të merren me këtë zeje edhe pas kurseve, dhe atyre u është ndihmuar me blerjen e mjeteve të punës. Këta shembuj, tha z. Haskuka, tregojnë se si gjërat duhet të shkojnë së bashku: ekonomia me arsimin, arsimi me kulturën e sportin, e kështu me radhë.

Po ashtu, në diskutim u përfshi edhe z. Zaim Hajredini, asambleist nga AKR-ja në Kuvendin e Dragashit, që në fjalën e tij Kryetarit Haskuka, së bashku me Kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Shaban Shabanit, ua parashtrroi pyetjen se a planifikojnë ata të hartojnë programe të veçanta të përbashkëta për turizmin malor, dhe sidomos në infrastrukturë, meqë këto do të krijonin perspektiva të mira, si për punësimin e të rinjve, ashtu edhe në aspektin e rekreacionit. Në këtë pyetje Kryetari Haskuka u përgjgj duke përmendur atë që kohëve të fundit është miratuar Strategjia për Zhvillimin e Turizmit në Komunën e Prizrenit, ku një nga pikat kryesore është zhvillimi i turizmit malor. Këtu është diskutuar edhe për mundësinë që dy a tri fshatra, pjesërisht apo tërësisht të boshatisura, të kthehen në fshatra turistike. Kjo planifikohet të bëhet me

investitorë privatë, meqë ato janë fshatra me perspektivë të mirë turistike, dhe meqë janë në zonën drejt Dragashit dhe në të, kjo do të jetë veprimtari në të cilën do të ketë bashkëpunim.

Komuna e Suharekës

Pas fjalës lidhur me Komunën e Prizrenit në pjesën hyrëse të Konferencës, fjalën e mori znj. Mihrije Suka, Nënkryetare e Komunës së Suharekës. Duke i shprehur përgëzimet për Profilin e përgatitur nga KIPRED-i, ajo në fillim i shprehu disa rezerva lidhur me disa nga të dhënat e prezantuara. Kështu, ajo pati rezerva lidhur me nivelin e analfabetizmit në Suharekë, që sipas Profilit ishte 41 veta në 1,000 banorë, numër ky që, siç tha ajo, i dukej tepër i lartë duke patur parasysh që Suhareka i ka 33 shkolla dhe 3 shkolla të mesme. Po ashtu, Nënkryetarja Suka pati rezerva edhe për numrin prej 93 vetash në 1,000 banorë që në Komunën e Suharekës janë pa arsimim fillor, duke patur parasysh që arsimimi fillor është obligativ. Lidhur me arsimimin, znj. Suka theksoi që një problem i theksuar në Suharekë është rënia e nxënësve në arsimin fillor, e shkaktuar nga rënia e lindjeve dhe nga migrimi. Ajo e përmendi që gjatë vitit 2019 në Suharekë 96 nxënës e kanë braktisur shkollën për shkak të bashkimit familjar.

Më pas Nënkryetarja Suka u përqendrua në çështjen e nivelit mjaft të ulët të ekstremizmit në Komunën e Suharekës. Ajo përmendi që kanë qenë 5 raste të tilla, dhe se Komuna e Suharekës, Policia dhe Drejtoria e Shëndetësisë janë të angazhura në mbikëqyrjen e tyre dhe në integrimin e fëmijëve të tyre. Fëmijët nën mbikëqyrje janë të moshës 5–6 vjeçare, mbikëqyrjen e bën Policia dhe Drejtoria e Arsimit, dhe problemi kryesor është që familjet e tyre nuk kanë pranuar që ata fëmijë të integrohen në arsimin para-shkollor.

Duke folur për çështjet sociale, si ato të ndërlidhura me këto raste, por po ashtu edhe në përgjithësi, znj. Suka theksoi që Komuna e Suharekës punon për t'u ndihmuar këtyre dhe familjeve e fëmijëve të tjerë. Këtu ajo e përmendi ndihmën e Organizatës 'Jetimat e

Ballkanit,' e cila gjatë vitit 2019 i ka ndërtuar 27 shtëpi, dhe theksoi që ndërtimi i shtëpive do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020.

Në fund, duke folur për fushën e Kulturës dhe të Sportit, Nënkyetarja Suka theksoi që ky është një resor të cilit Komuna e Suharekës i kushton mjaft rëndësi, për të janë të ndara rreth 70.000€, dhe këto shkojnë për kulturë, rini dhe sporte, si dhe për një numër të festave tradicionale, si ajo e Thesarit, Festa e Mërgimtarëve, Festa e Çlirimit, etj.

Pas fjalës së Nënkyetares Suka, organizatori i Konferencës e përmendi që të dhënat e paraqitura në Profil për nivelin e analfabetizimit dhe për atë të shkollimit në Komunën e Suharekës janë marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, dhe se burimet e këtyre të dhënave janë cekur në punim. Po ashtu, KIPRED-i theksoi që në kuadër të këtij projekti më parë ishte bërë një studim krahasues i radikalizimit në komunat e Suharekës e të Podujevës, që kishin nivel të ulët të radikalizimit, me atë në komunat Kaçanik dhe Han të Elezit, që kishin nivel më të lartë të radikalizimit. Në atë kohë Policia e Kosovës ka thënë që numri i rasteve në Suharekë ishte 0, dhe ky numër tash është rritur në 5. Me një analizë të gjerë të ndikimit të faktorëve të ndryshëm, janë gjetur dy faktorë kryesorë që e kanë parandaluar ndonjë radikalizim të theksuar në Suharekë dhe në Podujevë. I pari ka qenë roli i Bashkësive Islame komunale në këto dy komuna, e të cilat nuk e kanë lejuar ndërtimin e xhamive nga burime që u janë dukur të dyshimta, dhe as imponimin e imamëve që e kanë përcjellur ndërtimin e xhamive nga donacionet e jashtme të tilla. Dhe faktori i dytë kryesor ka qenë bashkëpunimi i gjerë i Bashkësive Islame komunale në Suharekë e Podujevë me Komunat, me Policinë, me shkollat e mesme, etj., me qëllim të parandalimit të ndikimit të elementeve fetare me tipare radikale. Ky, siç u tha, ka qenë përfundimi i analizës dhe studimit të KIPRED-it. Po ashtu, lidhur me këtë u theksua që kur të krahasohen të dhënat socio-ekonomike të Suharekës me ato të Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit, shihet që këto janë mjaft të ngjashme, mirëpo,

komunat e Suharekës dhe të Podujevës, megjithatë, potencialet zhvillimore i kanë shumë më të mëdha se ato të komunave të Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit.

Pas kësaj fjalën e mori Asambleistja e Komunës së Suharekës nga radhët e Vetëvendosjes, Laureata Tafaj, e cila Kryetarit të Komunës së Prizrenit (ashtu siç u përmend në seksionin për këtë Komunë) ia shtroi pyetjet lidhur me ndihmën që Komuna e Prizrenit ua ka dhënë të rinjve pa ndihmën e Organizatës Help, si dhe për atë se çfarë ka bërë Komuna e Prizrenit për terrenet sportive në Prizren. Ashtu siç u përmend në seksionin për Komunën e Prizrenit, lidhur me ndihmën e Help-it, Kryetari Haskuka u përgjegj që në vitin 2018 kanë qenë 40 përfitues, dhe atë pa ndihmën e Help-it, ndërkaq, Help-i është përfshirë në vitin 2019, për ta rritur bashkëpunimin, ndihmën, dhe mbikëqyrjen. Ai theksoi që në Drejtorinë e Turizmit dhe të Zhvillimit Ekonomik shumica e projekteve janë bërë pa ndihmën e Help-it, por që ka patur bashkëpunim edhe me organizata të tjera. Si ilustrim, Kryetari Haskuka përmendi subvencionet në bujqësi, dhe donacionin e lopëve qumështore për fermerët. Në vitin 2016 është bërë donacioni i 40 lopëve, ndërkaq, deri në vitin 2019 ky numër është rritur në 99 lopë, në një situatë kur kanë qenë më shumë se 350 aplikues. Qëllimi i këtij projekti ka qenë vetëpunësimi, Tash, tha ai, është duke u gjetur dhe analizuar profili i përfituesve, por për këtë, sipas tij, nevojitet një kohë më e gjatë, për të patur mundësi për t'i parë trendet afatgjata: analiza e përfituesve, mosha, gjinia, efektet e projektit, punësimi, rritja e prodhimit të qumështit, etj. Ndërkaq, lidhur me pyetjen për terrenet sportive në Prizren, Kryetari Haskuka theksoi që në vitin 2018, pa asnjë buxhet, është bërë ndërtimi i pesë terreneve në shkollat e Prizrenit. Te qendrat sportive është bërë rregullimi i tribunave, por edhe i vetë terreneve për hendboll, basketboll, tenis, ku te shkolla '11 Marsi' kanë qenë dy terrene tenisi, dhe terreni futboll/basketboll/volejball. Po ashtu është ndihmuar edhe ndërtimi i palestrave për fitnes. Kryetari Haskuka e përmendi

edhe ndihmën e Ministrisë së Kulturës për ndërtimin e stadiumit në Sërbicë, në Lubizhdë, por edhe këtu Komuna e Prizrenit e bën pjesën e stadiumit për atletikë, sipas standardeve ndërkombëtare. Në fund ai përmendi edhe fillimin e ndërtimit të stadiumit në Zhur, sipas standardeve të UEFA-s, si dhe shprehu besimin që gjatë këtij viti do të finalizohet edhe puna në stadiumin 'Përparim Thaqi,' edhe përkundrejt disa problemeve që kanë dalë me operatorin.

Pas kësaj fjalën e mori z. Leonard Shala, asambleist i Kuvendit Komunal të Suharekës, i cili në fillim u përqendrua në nevojat dhe problemet e mirëfillta të grup-moshës 15–29 vjeç. Ai tha që problemi i mirëfilltë dhe më i madh i të rinjve është që atyre t'u krijohen kushte të barabarta kur aplikojnë nëpër konkurset e komunave, dhe jo që ata dhe aftësitë e tyre të sakrifikohen për punësimin e militantëve partiakë. Kjo krijon pabarazi të mëdha, tha ai, dhe i shkatërron shpresat e pjesëtarëve të kësaj grup-moshe për të jetuar në Kosovë.

Z. Shala po ashtu theksoi problemin e shpërputhjes së madhe midis të dhënave statistikore dhe gjendjes reale. Për shembull, vazhdoi ai, në Profil thuhet që në Suharekë janë 21 klube sportive, 1 bibliotekë, 3 shtëpi kulture, 4 shoqata kulturore dhe 1 qendër rinore. Ai shtoi që si qytetar dhe asambleist i Suharekës ai nuk e di se ku janë 3 shtëpitë e kulturës në Suharekë, meqë ai di vetëm për një të tillë që, për më tepër, është në renovim e sipër. Në Suharekë nuk ka shtëpi funksionale të kulturës. Ai po ashtu shtoi që nuk di gjë për 4 shoqatat kulturore, ato mund të jenë të regjistruara, por nuk janë funksionale: është vetëm 1 shoqatë kulturore, e regjistruar si OJQ, Shoqëria Kulturo-Artistike 'Jehona,' që dy javë para ngjarjeve festive të komunës fillon të punojë, i angazhon disa të rinj, në festë e prezantojnë një program, dhe me tender paguhet 7 deri në 10 mijë Euro. Po ashtu, shtoi ai, është vetëm një qendër rinore që funksionon në kontinuitet, dhe asnjë shoqatë kulturore që ka punë të vazhdueshme gjatë tërë vitit. Ai

po ashtu e shprehu bindjen që në Suharekë nuk janë 21 klube sportive, por që problemi këtu është se çka është klub sportiv. Bëhet një aktivitet, mblidhen disa njerëz, aplikojnë për subvencione në Komunën e Suharekës, e cila jep subvencione të tilla, në total 70 deri në 100 mijë Euro, por klube të mirëfillta janë Ballkani, që sipas mendimit të z. Shalës është privatizuar në tërësi, Ylli Golden Eagle që kryesisht sponsorizohet nga sponsorë privatë, dhe klubi i volejbollit. Mund të ketë edhe ndonjë tjetër, por 21 klube të mirëfillta në Suharekë nuk janë.

Më pas, asambleisti Shala përmendi që rreth 20% e buxhetit të Komunës së Suharekës shkon për Drejtorinë e Bujqësisë. Ka patur projekte që e kanë ndihmuar me subvencione këtë kategori, ferma e mini-biznese të ndryshme, ashtu që bujqit ta punësojnë veten dhe mundësisht edhe të tjerët, dhe kjo nismë, theksoi Shala, ka qenë shumë e mirë. Mirëpo, kur të shikohet si kanë përfunduar këto investime, shihet që kjo në shumicën e rasteve ka shkuar kot – para pesë vitesh dikujt i janë dhënë 30 mijë Euro për ndërtimin e një shtalle, ajo është ndërtuar, dhe sot kur të shkosh ta shohish se ku ka arritur e sheh që shtalla sot nuk ekziston fare. Kështu që, përfundon z. Shala, duhen jo vetëm subvencione, por edhe që ato të mbikëqyren.

Po ashtu, një hendikep i madh është edhe mungesa e shoqërisë civile lokale. Mund të ketë shoqata të regjistruara, tha asambleisti Shala, por nuk ka shoqëri civile. Nuk ka televizion lokal të Suharekës, shtoi ai, janë TV Prizreni dhe Opinioni, por kur ke ndonjë nevojë a kërkesë për ta, ata kërkojnë të paguhen për t'i plotësuar ato. Po ashtu, shtoi z. Shala, nuk ka as portale.

Në fund, asambleist Shala e përmendi si një problem tejet të rëndë të rinisë edhe përdorimin e substancave narkotike, pra, të drogave të lehta. Sipas tij, të gjithë njerëzit e njohin, e shohin dhe e flasin këtë problem, dhe posaçërisht të rinjtë e kësaj grup-moshe.

Kjo, përfundoi asambleisti Leonard Shala, e paraqet një problem që gjithsesi duhet të trajtohet.

Pas fjalës së z. Shalës, organizatori i Konferencës e vuri në dukje që burimi i të dhënave që i diskutoi ai, për KIPRED-in ka qenë Drejtoria Komunale për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë e Suharekës, në një komunikim zyrtar të KIPRED-it me Komunën e Suharekës. Ndërkaq, te analizimi i çështjes së përdorimit të drogave, organizatori i Konferencës shtoi që problem është ardhja deri te të dhënat e pakontestueshme. Për shembull, u përmend që mund të mblidhen të dhëna nga Policia e Kosovës, për shembull, për profilin e veprave penale, mirëpo këto nuk mund ta ndihmojnë analizën e përhapjes së dukurisë. Ka plot organizata të tjera që mund të dalin me të dhëna kundërshtuese. KIPRED-i e theksoi që ka lidhje me organizata e persona që merren me këtë problematikë, mirëpo këtu çështja e të dhënave është tejet problematike, gjë që e vështirëson jashtëzakonisht shumë trajtimin e këtij problemi që gjithsesi duhet të trajtohet.

Pas këtyre vërejtjeve të organizatorit, fjalën e mori z. Dukagjin Palushi, asambleist i Kuvendit Komunal të Suharekës nga radhët e AAK-së. Ai e theksoi si problem atë që u përmend nga pararendësit, pra, rehatimin e njerëzve të afërt me pushtetin në sektorin publik, por ai po ashtu i shprehu rezervat e tij për përkrahjen e sektorit privat. Ai e përmendi si një problem madhor diskriminimin e punëtorëve në sektorin privat. Punëtorët aty punojnë edhe nga 16 orë në ditë për paga për keqardhje. Ai theksoi që Komuna e Suharekës, si një ilustrim, nuk ka Inspektorat të Punës. Ky problem, sipas tij duhet trajtuar urgjentisht dhe seriozisht, meqë një nga arsyt kryesore pse rinia e braktis vendin është, jo pamundësia për të gjetur punë, por pamundësia për të gjetur punë që do të krijojë mirëqenie. Rina nuk sheh shpresë këtu, tha asambleisti Palushi, shpresa kanë vetëm ata që janë të afërt me pushtetin.

Në vërejtjen e bërë nga organizatori i Konferencës, që çështja e Inspektoratit të Punës është tejet problematike, meqë veprimi i këtij Inspektorati është reaktiv, jo proaktiv, pra, ky Inspektorat nuk i kontrollon bizneset, por vetëm reagon kur ka ankesa, z. Palushi u përgjigj duke thënë se punëtorët, edhe përkundrejt gjendjes së tyre të vështirë, e kanë të vështirë, nëse jo edhe të pamundur, të ankohen, meqë do të mbeteshin edhe pa atë punë që e kanë. Prandaj, shtoi ai, ne këtu duhet të dalim me rekomandimin që veprimi i Inspektoratit të Punës duhet të bëhet proaktiv, me intervista anonime. Si ilustrim ai e përmendi një praktikë tejet të rëndë: kur gratë punëtore mbeten shtatzëna, tha ai, punëdhënësi i tyre atyre ua çet edhe pagën, dhe ua paguan edhe tatimet e trustin pensional. Mirëpo, në ato firma ka punëtorë që i mbajnë, edhe kartelet, edhe PIN-at e atyre punëtoreve që kanë mbetur shtatzëna, dhe pasi që atyre u paguhen pagat, ata menjëherë ua marrin ato dhe i kthejnë në xhiro-llogarinë e firmës. Pra, tha ai, rrogat barten në xhirollogaritë e punëtoreve që kanë mbetur shtatzëna vetëm sa për sy e faqe, ashtu që firma t'i ketë punët mirë me shtetin dhe institucionet, ndërkaq, punëtorja në xhirollogarinë e të cilës është bartur rroga, atë rrogë as nuk e merr, dhe as nuk e sheh fare.

Në fund, fjalën e mori përsëri Nënkyetarja e Komunës së Suharekës, znj. Mihrije Suka, që u përqendrua përsëri në lëvizjet demografike. Ajo theksoi që këto lëvizje janë të dyfishta, nga Kosova jashtë, por edhe nga fshati në qytet. Në fshatra, theksoi ajo, është bërë punë e madhe në ndërtimin e infrastrukturës, por, megjithatë, të gjithë dëshirojnë të jetojnë në qytet, kështu që, një pjesë e madhe e atyre që i braktisin fshatrat shkojnë nëpër qytetet e Kosovës, jo vetëm jashtë saj. Mirëpo, shtoi ajo, problemi më i madh, megjithatë, është shkuarja jashtë. Ajo këtë e ilustroi me faktin që gjatë vitit 2018, në Komunën e Suharekës 140 persona kanë hequr dorë nga shtetësia, ndërkaq, gjatë vitit 2019, ky numër është rritur në 146. Ky, sipas Nënkyetares Suka, është një problem i

rëndë, jo vetëm për Suharekën, por edhe për të tërë Kosovën, dhe duhet që gjithsesi të analizohet.

Komuna e Dragashit

Në diskutimin lidhur me Komunën e Dragashit fjalën së pari e pati z. Shaban Shabani, Kryetarit të Komunës së Dragashit. Në fjalën e tij ai çështjet i diskutoi kryesisht sipas radhës siç ato ishin të parashtruara në Profil.

Duke e diskutuar çështjen e strukturës së popullsisë, z. Shabani theksoi që Agjencia e Statistikave, nga e cila janë marrë të dhënat, është dashur ta merr parasysh që numrat e saj kanë patur të bëjnë vetëm me banorët rezidentë në komunë. Gjatë regjistrimit të popullatës, theksoi z. Shabani, është bërë regjistrimi vetëm i banorëve që janë këtu, jo edhe ai i bashkatdhetarëve tanë që janë jashtë. Si pasojë, në nivelet lokale, struktura e popullsisë ndryshon nga ajo që jipet në nivelin qendror, meqë një pjesë e familjarëve të bashkatdhetarëve tanë që janë jashtë, ata i kanë regjistruar këtu, domethënë, në nivelin komunal. Dhe kjo, sipas Kryetarit Shabani, është një mospërputhje që shkakton probleme serioze të planifikimit të buxhetit, meqë buxheti planifikohet duke u bazuar në popullatën, ndërkohë, numrat lidhur me të, në nivelin qendror dhe atë lokal ndryshojnë.

Lidhur me arsimin, Kryetari Shabani e shprehi pajtimin parimor me nevojën e përmendur për krijimin e profileve të reja për të cilat ekziston kërkesa në treg. Mirëpo, ai e theksoi problemin me të cilin do të përballen komunat kur të mbyllen drejtimet e vjetra, dhe kur personeli i atyre drejtimeve të vjetra të mbetet pa punë. Ministria, siç e theksoi ai, kërkon nga komuna që të kujdeset për atë staf, kështu që ata në fund do të mbeten barrë e komunës. Prandaj, tha z. Shabani, të reformimit të sistemit arsimor duhet të shkohet me shumë kujdes sa i përket problemeve të implementimit dhe të sistemit të personelit që do të mbetet pa punë. Ideja, shtoi Kryetari Shabani, është shumë e mirë, mirëpo implementimi i saj do të hasë në vështirësi të mëdha.

Sa i përket ekstremizmit të dhunshëm, z. Shabani theksoi që Dragashi i ka patur rreth 6 qytetarë pjesëmarrës në luftrat e huaja, dhe që organet e sigurisë kanë intervenuar me kohë. Fillimisht, tha ai, ishte një amulli, nuk dihej se çfarë po ndodhte, disa thoshin 'luftë e drejtë,' kështu që shoqëria nuk ia doli ta bënte një preventivë në fazën e hershme. Mirëpo, kjo më vonë shkoi mirë. Ai theksoi që edhe në Dragash Bashkësia Islame e komunës ka dhënë kontribut të konsiderueshëm. I përmendi disa takime të saj me rininë dhe me nxënësit e shkollave, që u organizuan me ndihmën e organizatave të huaja. Më pas ai tha që është e vërtetë që në Dragash nuk ka patur ndonjë séancë të veçantë që i është kushtuar në tërësi kësaj çështjeje, mirëpo çështja e radikalizmit është trajtuar si e pjesshme në një numër të madh seancash e mbledhjesh të tjera, si për shembull në Komitetin për Politikë e Financa, dhe, po ashtu, ka qenë një trajnim i veçantë në Këshillin për Siguri në Bashkësi. Po ashtu, ai theksoi që organizatat e huaja kanë dhënë ndihmë të konsiderueshme në nivelin e shkollave të mesme.

Lidhur me nivelin e kriminalitetit në Komunën e Dragashit, Kryetari Shabani theksoi që meritat poër gjendjen e mirë i shkojnë si popullatës, ashtu edhe organeve të sigurisë.

Ndërkaq, duke e diskutuar çështjen e strukturës së popullsisë sipas aktivitetit ekonomik, z. Shabani vuri në dukje që komuna e Dragashit nuk mund të krahasohet me atë të Prizrenit, thjesht, meqë në Dragash vetëm 3.2% e qytetarëve jetojnë në zonën urbane, ndërkaq, mbi 96% jetojnë në zonën rurale. Si pasojë, komuna e Dragashit nuk mund të ofrojë punësim për të gjithë rininë që e ka, kështu që ka mjaft migrim në drejtim të Prizrenit dhe të Prishtinës. Kjo lëvizje, sipas tij, vërehet posaçërisht te njerëzit me nivel më të lartë të arsimimit.

Sa i përket aktiviteteve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sporteve, Kryetari Shabani theksoi që mundësitë janë të vogla dhe modeste. Ato pak mundësi që janë, shfrytëzohen për t'i ndihmuar paksa organizatat e ndryshme, qoftë kulturore, rinore apo sportive,

dhe kjo bëhet përmes thirrjeve publike. Janë disa investime modeste për aktivitetet e përgjithshme në shtëpinë e kulturës. Në Dragash, sipas Kryetarit Shabani, vepronë rreth dy organizata të rinisë, katër klube e shoqëri kulturo-artistike. Mirëpo, jashta thirrjeve publike, theksoi ai, nuk ka mundësi të tjera për t'i ndihmuar.

Pas kësaj, fjalën e mori asambleisti i Kuvendit të Dragashit nga radhët e AKR-së, z. Zaim Hajredini i cili i parashtrroi dy pyetje. Së pari, ai theksoi që Kryetari Shabani ka patur një bashkëpunim të mirë me Asamblenë, dhe e ka ndarë një buxhet për mbështetjen e shoqërisë civile në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Dhe pyetja e tij e parë ishte nëse ky bashkëpunim do të vazhdojë më tutje, meqë fuqizimi i shoqërisë civile e ka patur një efekt pozitiv në Komunën e Dragashit. Ndërkaq, pyetja e dytë e z. Hajredinit, që, pos Kryetarit Shabani, iu drejtua edhe Kryetarit të Komunës së Prizrenit, z. Mytahir Haskukës, ishte se a planifikojnë këta dy kryetarë të përgatisin programe të veçanta sa i përket turizmit malor, dhe sidomos në infrastrukturë, meqë kjo do të krijonte persepektiva të mira për të dyja komunat, si për punësimin e të rinjve, ashtu edhe në aspektin e rekreacionit.

Në pyetjen e parë Kryetari Shabani u përgjigj duke theksuar që në buxhet tashmë është bërë planifikimi për vazhdimin e përkrahjes së shoqërisë civile. Vështirë që do të mund të bëhet aq sa janë nevojat, tha ai, por gjithsesi do të bëhet aq sa do të jenë mundësitë. Ai shtoi që planifikohet edhe ndarja e bursave për studentë. Sa i përket aktiviteteve për kulturën, rininë dhe sportin, ai tha që janë nënshkruar marrëveshje midis komunave dhe kryetarëve me Koordinatorin për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe janë zhvilluar aktivitete edhe në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Ai shtoi edhe që në kuadër të kësaj ka patur gara që kanë qenë, edhe të nivelit lokal, edhe të atij shtetëror. Ndërkaq, në pyetjen e dytë lidhur me veprimet e përbashkëta me Komunën e Prizrenit në fushën e turizmit, përqendrimi i Kryetarit Shabani ishte te pika e Gurit të Zi, në fshatrat e zonës kadastrale

Prizren dhe Dragash, duke theksuar që kjo është një mundësi e mirë për investim dhe bashkëpunim ndërkomunal.

Në fund, në pyetjen e dytë të asambleistit Hajredini u përgjigj edhe Kryetari Haskuka, i cili, ashtu siç u cek në seksionin për Komunën e Prizrenit, tha që kohëve të fundit është miratuar Strategjia për Zhvillimin e Turizmit në Komunën e Prizrenit, ku një nga pikat kryesore është zhvillimi i turizmit malor. Këtu është diskutuar edhe për mundësinë që dy a tri fshatra, pjesërisht apo tërësisht të boshatisura, të kthehen në fshatra turistike. Kjo planifikohet të bëhet me investitorë privatë, meqë ato janë fshatra me perspektivë të mirë turistike, dhe pasi që ato janë në zonën midis Prizrenit e Dragashit, kjo do të jetë veprimtari që do të organizohet bashkarisht.

Komuna e Mamushës

Diskutimin për Komunën e Mamushës e udhëhoqi kryesisht Kryetari i Komunës, z. Abdulhadi Krasniq, i cili, duke folur së pari për arsimin, theksoi atë që Mamusha fillimisht ishte fshat në komunën e Prizrenit, dhe që tash është bërë Komunë fuqiptotë. Para vitit 1999, theksoi ai, arsimi në Mamushë ka qëndruar keq, ndërkaq, pas luftës ai është në një gjendje më të mirë. Në nivelin e arsimit të ulët Mamusha qëndron mjaft mirë, ndërkaq në nivelin më të lartë është pak më dobët. Mirëpo, edhe në nivelin e arsimit të lartë situata është duke u përmirësuar; tash Mamusha, sipas Kryetarit Krasniq, i ka rreth 200 studentë duke studiuar në Turqi, dhe ka mjaft edhe në Kosovë. Në aspektin gjinor ai përmendi se të gjithë 5 a 6 studentët që në Turqi studiojnë mjekësinë janë femra. Përqindja e femrave, sipas tij, është dukshëm më e lartë edhe në shkollat e mesme të Mamushës. Kryetari Krasniq theksoi që analfabetizmi në Mamushë mund të jetë pak më i lartë, por kjo në masë të madhe shkaktohet nga fakti që mjaft persona të moshuar janë analfabetë.

Lidhur me çështjen e fesë në Mamushë, Kryetari Krasniq tha që Mamusha i ka dy xhami, dhe që nuk ka pasur pjesëmarrës në luftrat e huaja. Fakti që të gjithë banorët e Mamushës janë myslimanë, tha ai, nuk ka krijuar mundësi për shfaqjen e konflikteve fetare.

Sa i përket gjendjes ekonomike në Mamushë ai theksoi që veprimtaria ekonomike në Mamushë është kryesisht bujqësore, dhe që kjo është shumë e mirë: 97% të banorëve janë të punësuar. Ai e lavdëroi prodhimtarinë bujqësore të Mamushës si shumë të zhvilluar dhe të avancuar, dhe tha që Mamusha mund ta furnizojë të tërë Kosovën me produkte bujqësore, meqë mamushalinjtë, siç e theksoi, janë shumë punëtorë.

Ndërkaq, duke folur për ndihmën sociale dhe investimet për rini në Mamushë, Kryetari Krasniq theksoi që gjendja sociale është e mirë meqë Mamusha është e vogël dhe të gjithë njerëzit e njohin njëri-tjetrin, kështu që ata ndihmohen, pra, nuk ka ndonjë nevojë të madhe për ndihmë sociale. Për investimet për rini ai tha që ato janë pothuaj inekzistente, meqë nuk ka buxhet. Po ashtu, nuk ka as infrastrukturë – ai theksoi që Mamusha është pothuaj e vetmja komunë në Kosovë që nuk ka shtëpi të kulturës, dhe as bibliotekë. Mamusha për herë të parë vitin e kaluar i ka bërë disa përpjekje për t'i grumbulluar disa fonde për investime në rastet sociale, në arsim, për rini, kulturë, etj., kanë qenë dikund rreth 20.000 €. Rreth fundit të vitit është bërë një mbështetje e shoqatave, por edhe fondet kanë qenë të vogla, dhe edhe numri i kërkuesve ka qenë i vogël.

Në fund, Kryetari i Mamushës, z. Abdulhadi Krasniq i bëri edhe disa komentime për ato që u thanë nga pjesëmarrësit e tjerë të Konferencës. Ai tha që ajo që Kryetari i Prizrenit, z. Haskuka e tha, për atë se si për një vend pune në Komunën e Prizrenit aplikojnë nga mbi 300 aplikantë, vlen për të gjitha komunat, për Mamushë, Suharekë, etj. Motivimi i të rinjve për të punuar në sektorin publik e shtetëror, tha ai, është shumë më i lartë se për të punuar në sektorin privat. Unë, shtoi ai, si Kryetar i Mamushës, çdo ditë kam kërkesa për ta punësuar dikë, në kohën kur sektori privat ka probleme të theksuara për gjetjen e punëtorëve. Prandaj, ai theksoi që pajtohet me kërkesat që duhen bërë reforma në sistemin arsimor, ashtu që sa më shumë njerëz të aftësohen për kërkesat e sektorit privat, por, po ashtu, ai pajtohet edhe me nevojën që bizneset të kontrollohen më mirë për mënyrën se si aty trajtohen punëtorët.

Consortium: "With Participatory Democracy for a Kosovo without Radicalization" | Konzorciumi: "Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizim"

